

VENDIM
Nr. 34/2022

**PËR NGRITJEN E NËNKOMISIONIT PËR ZHVILLIM TË QËNDRUESHËM,
NË PËRBËRJE TË KOMISIONIT TË PËRHERSHËM PARLAMENTAR
PËR EKONOMINË DHE FINANCAT**

Në mbështetje të nenit 78, pika 1, të Kushtetutës dhe të neneve 19, pika 2, 21, pika 1, dhe 55, pika 1, të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Konferencës së Kryetarëve,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Ngrihet Nënkomisioni për Zhvillim të Qëndrueshëm në përbërje të Komisionit të Përhershëm Parlamentar për Ekonominë dhe Financat.

II. Fusha e përgjegjësisë së këtij Nënkomisioni është zhvillimi ekonomik dhe social, rritja ekonomike e qëndrueshme, realizimi i objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm dhe Agjenda 2030 e OKB-së.

III. Nënkomisioni përbëhet nga 7 anëtarë si më poshtë:

Anila Denaj	kryetare	(PS);
Sorina Koti	zëvendëskryetare	(PD);
Enslemvera Zake	anëtare	(PS);
Pranvera Resulaj	anëtare	(PS);
Blerina Gjylameti	anëtare	(PS);
Emilja Koliqi	anëtare	(PD);
Arbër Agalliu	anëtar	(PD).

Anëtarë zëvendësues:

Antoneta Dhima	(PS);
Etjen Xhafaj	(PS);
Fatjon Veizaj	(PD).

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Lindita Nikolla

Miratuar në datën 14.4.2022.